

Universiteti "Ukshin Hoti" University of Prizren Universiteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Prindëri i protokollit	07.11.2023
Shifra e protokollit	01-554
308	



## UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000  
Prizren, Republika e Kosovës  
[www.uni-prizren.com](http://www.uni-prizren.com)

# RREGULLORE PËR TË ARDHURAT PERSONALE TË PERSONELIT AKADEMIK, SHITESAT SIPAS FUNKSIONEVE DHE KOMPENSIMET TJERA NË UNIVERSITETIN "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Prizren, 2023



**Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren**  
University "Ukshin Hoti" Prizren

**KËSHILLI DREJTUES**

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren - Kosovë; Tel: +381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

**Kryesues i Këshillit Drejtues**  
**Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja**

**Prizren, më 27.11.2023**

Në mbështetje të nenit 23, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, nën-nënparagrafi 1.6.2. të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, Këshilli Drejtues i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 16.11.2023, miratoi këtë:

**RREGULLORE**

**për të ardhurat personale të personelit akademik, shtesat sipas funksioneve dhe kompensimet tjera në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Kjo rregullore ka për qëllim të rregulloj çështjet e të ardhurave personale, pagesat dhe kushtet e shërbimit për personelin, procedurat e mënyrave të kompensimit të punës për personelin akademik në marrëdhënie pune të rregullt apo të angazhuar në UUHP, shtesat funksionale për ushtrimin e funksionit përkatës, si dhe kompensimin e punës të anëtarëve të komisioneve të specifikuar në këtë rregullore, të cilat emërohen brenda UUHP-së, duke mos përjashtuar edhe çështjet e tjera që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në të ardhurat personale duke u bazuar në legjislacionin e zbatueshëm në Universitetin "Ukshin Hoti".

**Neni 2**  
**Përkufizimet dhe shkurtesat**

1. Për nevoja të kësaj rregulloreje shprehjet e mëposhtme dhe shkurtesat e kanë kuptimin si në vijim:
  - 1.1. **MASHTI** - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
  - 1.2. **UUHP** - Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren;
  - 1.3. **Bashkëpunëtor i jashtëm** - Mësimdhënësi, lektori dhe asistenti i angazhuar, i cili nuk ka marrëdhënie të rregullt pune me UUHP-në ose ka pezulluar marrëdhënien e punës në UUHP (sipas ligjeve në fuqi dhe vendimeve të organeve të UUHP-së) dhe angazhohen me një fond të caktuar të orëve, duke respektuar kriteret dhe procedurat, të përcaktuara me Statut dhe rregulloret në fuqi, përfshirë edhe mësimdhënësit dhe lektorët që angazhohen në kuadër të bashkëpunimit me ambasada dhe agjenci shtetërore të vendeve përkatëse si: USAID, DAAD, OEAD, por edhe agjenci shtetërore të shteteve të tjera, të cilët kanë bashkëpunim me njësitë akademike të UUHP-në;
  - 1.4. **FE** - Fakulteti i Ekonomisë;

- 1.5. **FF** - Fakulteti i Filologjisë;
- 1.6. **FE** - Fakulteti i Edukimit;
- 1.7. **FSHK** - Fakulteti i Shkencave Kompjuterike;
- 1.8. **FJ** - Fakulteti Juridik;
- 1.9. **FSHJM** - Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit;
- 1.10. **Normë e plotë** - Nënkupton fondin e orëve mësimore për personelin akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UUHP, e cila pasqyrohet edhe në kontratën e punës;
- 1.11. **Punë shtesë** - Punë ose angazhim me orë shtesë, që tejkalojnë orët e përcaktuara për normë të plotë, në rastin e personelit akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UUHP;
- 1.12. **Koeficienti** - Nënkupton shprehjen numerike që korrespondon me klasën dhe grupin e pagës. Bazuar në këtë koeficient, llogaritet paga bazë për çdo pozicion;
- 1.13. **Pagë shtesë** - Pagë shtesë në përqindje të pagës bazë e cila i takon personelit akademik për punën më të gjatë se orët e përcaktuara me normë të plotë dhe për punë gjatë fundjavës;
- 1.14. **Shtesë funksionale** - Shtesa funksionale e cila i takon personelit akademik për ushtrimin e funksionit përkatës, siç parashihet në legjislacionin e zbatueshëm dhe në Statutin e UUHP-së;
- 1.14. **Funksionarë publikë** - Nënkupton: të zgjedhurit; anëtarët e Qeverisë dhe zëvendësit e tyre; funksionarët e emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, titullarët apo anëtarët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të agjencive të pavarura; të emëruarit politik në nivelin qendror dhe lokal; drejtori apo anëtarët e organit drejtues kolegjial të agjencive rregullatorë;
- 1.15. **Profesor vizitor/i ftuar** - Nënkupton mësimdhënësin e angazhuar nga një Universitet dhe institucion tjetër ndërkombëtar i arsimit të lartë;
- 1.16. **SMU** - Sistemi i Menaxhimit Universitar.

### **Neni 3**

#### **Dispozitat e përgjithshme**

1. Mjetet për të ardhurat personale shfrytëzohen nga fondi i Buxhetit të Republikës së Kosovës, tarifatat e shkollimit dhe pagesat e tjera të studentëve, pagesat e shërbimeve komerciale, donacionet dhe nga kontratat me mekanizma kombëtarë dhe ndërkombëtarë, publikë dhe privatë.
2. Nga burimet financiare të pasqyruara në paragrafin 1 paguhen të ardhurat personale dhe kompensimet e tjera të personelit në marrëdhënie të rregullt pune, shtesat sipas funksioneve dhe kompensimeve tjera, puna me normë të plotë dhe puna shtesë e personelit akademik të rregullt dhe bashkëpunëtorët e jashtëm në Universitetin "Ukshin Hoti".
3. Lartësia e të ardhurave personale caktohet në bazë të koeficientëve dhe thirrjeve të koduara në shërbimin qendror për të ardhurat, sipas kodimit unik për tërë nëpunësit publikë të arsimit në Kosovë.
4. Shërbimi për financa i UUHP-së e bën përlllogaritjen e të ardhurave personale dhe pagesave tjera, në bazë të vendimeve dhe kontratave të organeve të UUHP-së. Mbi këtë bazë

menaxhmenti i UUHP-së jep urdhër për realizimin e pagesave sipas vendimeve dhe kontratave të cilat lidhen me të punësuarit, me rastin e angazhimit.

#### **Neni 4**

##### **Marrëdhënia e punës e personelit akademik**

1. Me personelin akademik në marrëdhënie të rregullt pune, në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm në Universitetin "Ukshin Hoti", lidhet kontratë pune në kohëzgjatë të caktuar, në pajtim me kushtet për emërim dhe titullin akademik.
2. Personelit akademik që i ka përfunduar kontrata e punës si në paragrafin 1, si pasojë e shtyrjes së hapjes së konkursit për shkak të rrethanave objektive jashtë vullnetit të tij, përkatësisht vonesave në përfundimin e procedurave të emërimit, riemërimit apo avancimit, i vazhdohet kontrata në thirrjen aktuale deri në përmbylljen e procedurave të konkursit të radhës të shpallur pas skadimit të kontratës përkatësisht deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga ana e Senatit lidhur me konkursin në cilin ka aplikuar kandidati.
3. Duke u bazuar në rregulloret e brendshme në fuqi, UUHP-ja angazhon në mësimdhënie, për kohë të caktuar dhe sipas nevojës, bashkëpunëtorë të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime, profesorë vizitorë dhe personelin akademik të pensionuar me të drejtë angazhimi, duke u bazuar në legjislacionin e zbatueshëm në UUHP.
4. Në kuadër të marrëdhënies së punës, përpos normës së plotë të ligjëratave dhe ushtrimeve për personelin akademik, sipas kontratës (40 orë në javë) hyjnë edhe angazhimet si në vijim: përgatitja e ligjëratave dhe ushtrimeve; mbikëqyrja e punimeve të diplomës dhe seminareve në studimet baçelor dhe master, si dhe pjesëmarrja në komisione; përgatitja dhe mbajtja e provimeve dhe konsultimeve si dhe detyra dhe angazhime të tjera, bazuar në aktet në fuqi të UUHP-së.
5. Marrëdhënia e punës me normë të plotë, si dhe angazhimet e tjera bëhen sipas vendimeve të organeve kompetente dhe kontratave individuale të lidhura në mes të UUHP-së dhe personelit akademik.

#### **Neni 5**

##### **Kufizimet në marrëdhënien e punës me normë të plotë**

1. Personeli në marrëdhënie të rregullt pune nuk mund të ketë kontratë tjetër të punësimit me normë të plotë në ndonjë universitet apo institucion tjetër, por mund të jetë i angazhuar pas marrjes së pëlqimit nga Rektori (punëdhënësi primar) në përputhje me legjislacionin në përkatës në fuqi.
2. Kriteret e kufizimeve përkitazi me angazhimet shtesë të personelit akademik në ndonjë institucionin tjetër, brenda apo jashtë vendit, përcaktohen me legjislacionin e zbatueshëm dhe vendimet përkatëse të organeve kompetente të UUHP-së.

**Neni 6**  
**Adresimi i përgjegjësish disiplinore**

Për shkelje dhe mos përmbushje së vazhdueshme të detyrave të punës, do të zbatohet procedura disiplinore dhe masat e përcaktuara në pajtim me Statutin e UUHP-së, Kodin e Etikës, aktet e ligjore dhe nënligjore të zbatueshme të Universitetit.

**Neni 7**  
**Kompensimi për normën e rregullt të personelit akademik**

1. Punë me orar të plotë konsiderohet puna me kohëzgjatje javore prej dyzet (40) orësh.
2. Për personelin akademik në marrëdhënie të rregullt pune, përcaktohet norma e plotë e orëve javore të mësimit dhe lartësia e pagës sipas titujve akademik.
3. Për angazhim me orë shtesë, që tejkalojnë orët e përcaktuara për normë të plotë javore të mësimit, personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UUHP, përfiton pagë shtesë në përqindje të pagës bazë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Norma e plotë e orëve javore të mësimit për personelin akademik dhe pagesa përkatëse është si në vijim:

**Tabela nr. 1.**

Nr.	Titulli akademik	Norma e plotë e orëve javore të mësimit	Koeficienti <sup>1</sup>	Paga bazë
1.	Profesor i rregullt	6 (gjashtë)	12.4	1302.00 €
2.	Profesor i asocuar	6 (gjashtë)	11.4	1197.00 €
3.	Profesor asistent	6 (gjashtë)	10.4	1092.00 €
5.	Asistent	10 (dhjetë)	7.2	756.00 €

5. Me qëllim të kompensimit dhe implikimeve buxhetore, kusht për shpalljen e konkursit për vendet e reja në UUHP, për mësimdhënës, asistent, lektorë dhe korepetitorë është plotësimi i së paku 50% të orëve të parapara me normë të plotë në lëndët obligative, kurse pjesa tjetër në lëndët zgjedhore ose në praktikën klinike.
6. Në rastet kur njësitë akademike i dëshmojnë Senatit rrezikimin e akreditimit/ri-akreditimit të programeve dhe fondi i orëve në fushën e caktuar nuk mund të plotësohet me orë të ligjëratave, brenda vitit akademik lejohet fondi prej së paku 8 orë ligjërata, ndërsa orët tjera mund të plotësohen me ushtrime. Ushtrimet duhet të janë në lëndët për ligjërata e të cilave është duke u shpallur konkursi. Edhe në këtë rast së paku 50% e ligjëratave përkatësisht 4 orë duhet t'i takojnë lëndëve obligative, ndërsa pjesa tjetër mund të mbulohen me ligjërata nga lëndët zgjedhore.

<sup>1</sup> Vlera monetare e koeficientit përcaktohet me Ligjin mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës. Përcaktimi i vlerës së koeficientit bëhet në pajtim me legjislacionin për menaxhimin e financave publike.

7. Plotësimi i orëve të nevojshme mësimore për shpalljen e konkursit për mësimdhënës si në paragrafin 5 dhe 6 të këtij neni nuk mund të bëhet me orë të ligjëratave nga norma e mësimdhënësve të cilët tashmë janë të emëruar, përkatësisht nëpërmjet zëvendësimit të orëve të ligjëratave të mësimdhënësve tashmë të emëruar me orë të ushtrimeve.
8. Obligohet dekani i njësisë akademike përkatëse dhe sekretari i njësisë akademike përkatëse ta njoftojnë për çdo muaj Sekretarin e Përgjithshëm dhe NJMBNJ-në, dhe të konfirmojnë vijueshmërinë e personelit në punë në mënyrë që pagesa të bëhet në përputhje me kontratat e personelit. Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit dhe zyrtari i politikave për paga, nuk mbajnë përgjegjësi për mosrespektimin e kontratave të punës të personelit akademik dhe administrativ, nëse nuk ka ndonjë dokument i cili konstaton mosrespektimin e kontratës së punës të dërguar nga njësitet akademike.

### **Neni 8**

#### **Kompensimi i personelit akademik për orët shtesë të punës**

1. Personelit akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UUHP, i takon pagë shtesë për çdo orë mësimore të mbajtur jashtë normës së plotë si në nenin 7, paragrafi 4, Tabela nr. 1.
2. E drejta e kompensimit shtesë zbatohet deri në masën prej 30% të pagës bazë dhe në proporcion me orët e punës (si në Aneksin 1 të kësaj rregulloreje).
3. Llogaritja e lartësisë së kompensimit për orë shtesë të punës si në paragrafin 2 bëhet mbi pagën bazë. Kjo llogaritje mund të varijojë në raport me rritjen e pagës bazë për shkak të përvojës të punës, sipas përcaktimeve të legjislacionit relevant në fuqi.
4. Këshilli i njësisë akademike, në fillim të vitit akademik përkatës, identifikon dhe konstaton nevojat për angazhimin e personelit e rregullt akademik me orë shtesë të punës sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
5. Departamenti/Programi studimor i parashtron Këshillit të njësisë akademike, kërkesë për lejimin e angazhimit të personelit akademik si në paragrafin 2. Kërkesa duhet të dorëzohet jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë para fillimit të vitit të ri akademik, respektivisht para fillimit të semestrit veror (në rastet kur angazhimi bëhet vetëm për këtë semestër).
6. Kërkesa e njësisë akademike, i përcillet për vendimmarrje rektorit, si autoritet kryesor menaxhues, jo më pak se dhjetë (10) ditë para ditë para fillimit të vitit të ri akademik, respektivisht para fillimit të semestrit veror (në rastet kur angazhimi bëhet vetëm për këtë semestër). Përgjashtimisht, ky afat nuk aplikohet në rast të rrethanave të cilat nuk mund të parashihen, e që janë jashtë kontrollit dhe pavarësisht vullnetit të institucionit.
7. Rektori, brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i kërkesës të njësisë akademike, merr vendim si në paragrafin 6 të këtij neni.
8. Mësimdhënësit në marrëdhënie të rregullt pune, sipas vlerësimit të njësisë akademike përkatëse dhe duke pasur parasysh nevojat, mund të mbajnë orë shtesë edhe të ushtrimeve, por jo më shumë se 3 (tri) orë për semestër, të cilat kompensohen si orë të ligjëratave, ashtu



siç është përcaktuar në këtë rregullore. Orët shtesë nuk mund të tejkalojnë fondin e orëve shtesë të punës, të përcaktuar me këtë rregullore. Orët shtesë të punës me ushtrime mund të llogariten vetëm pasi mësimdhënësi ta ketë plotësuar normën e plotë të mësimin me ligjërata dhe vetëm atëherë kur orët përkatëse nuk mund të mbulojnë nga asistentët.

9. Orët shtesë të punës nuk mund të barten prej një semestri në semestrin tjetër. Me rastin e caktimit dhe kompensimit të orëve shtesë për vitin akademik, paraprakisht duhet të plotësohet norma e plotë për vit akademik. Pasi të jetë plotësuar norma e plotë e personelit akademik në kuadër të programit/departamentit (për mësimdhënësit me ligjërata, për asistentët me ushtrime), orët e mbetura mund të kompensohen si orë shtesë.

#### **Neni 9**

#### **Angazhimi i personelit akademik të pensionuar**

1. Personeli akademik i pensionuar, që ka qenë në marrëdhënie të rregullt pune në UUHP, mund të angazhohet deri në normën javore të mësimin si nën 7, Tabela nr. 1, varësisht titullit akademik, me të drejtë të kompensimit për orë pune në lartësi të përqindjes (%) së kompensimit shtesë për orë pune të personelit në marrëdhënie të rregullt pune, si në Aneksin 1.
2. Personeli akademik si në paragrafin 1, bëhet mbi bazën e nevojave të njërive akademike dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara me legjislacionin e zbatueshëm në UUHP.

#### **Neni 10**

#### **Kompensimi për bashkëpunëtorët e jashtëm në UUHP**

1. Bashkëpunëtorëve të jashtëm, në përputhje me këtë rregullore, takon kompensimi për çdo orë të mbajtur, si në Aneksin 1.
2. Bashkëpunëtorëve të jashtëm, në përputhje me këtë rregullore, u takon kompensimi për më së shumti tetë (8) muaj brenda vitit akademik, sipas orëve të realizuara siç përcaktohet me këtë rregullore.
3. Lektorëve, të cilët angazhohen si rezultat i bashkëpunimit me ambasada dhe me agjenci shtetërore të vendeve përkatëse apo marrëveshjeve me universitete të huaja, në përputhje me këtë rregullore dhe marrëveshjen përkatëse. Angazhimi i kësaj kategorie të lektorëve bëhet nga Senati për çdo vit akademik.
4. Në raste të mungesës së bashkëpunëtorëve të jashtëm me gradën adekuate, në përputhje me rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm, për ligjërata në nivelin e studimeve baçelor mund të angazhohen përjashtimisht edhe kandidatët me gradën e Magjistratit (Mr. Sc.) ose Masterit (MA), sipas Statutit dhe rregulloreve në fuqi të UUHP-së.
5. Pagesa për kategorinë nga paragrafi 4 të këtij neni do të bëhet në lartësinë e pagesës së përcaktuar për bashkëpunëtorëve të jashtëm për ushtrime.

## **Neni 11**

### **Kompensimi i profesorëve vizitorë**

1. Profesorët vizitorë nga universitetet e vendeve të rajonit që kufizohen me Republikën e Kosovës, përfshirë Bosnjën dhe Hercegovinën, për çdo orë të mbajtur, kompensohen 25.00 € bruto.
2. Profesorëve vizitorë nga vendet jashtë rajonit, për çdo orë të mbajtur, u takon kompensimi 30.00 €.
3. Profesorët vizitorë angazhohen me propozim të Këshillit të njësisë akademike dhe miratimit përfundimtar të Senatit të UUHP-së. Angazhimi i profesorëve vizitorë mund të bëhet vetëm pas planifikimit paraprak nga njësia akademike përkatëse, para fillimit të vitit akademik.
4. Profesorit vizitor, nuk mund t'i kompensohen më shumë se njëzet e katër (24) orë brenda muajit, të cilat mund të mbahen sipas sistemit bllok, por jo më shumë se gjashtë (6) orë brenda një dite të punës.
5. Profesorit vizitor nga vendet jashtë rajonit do t'i mbulohen shpenzimet e biletës së udhëtimit, por jo më shumë se një (1) biletë kthyesë, sipas çmimit të arsyeshëm (ekonomik).
6. Në rastet kur UUHP-ja ka të nënshkruar memorandum mirëkuptimi me Universitete tjera, e në të cila parashihet shprehimisht shkëmbimi i profesorëve vizitor për cikël të kufizuar ligjëratash, dhe nëse një shkëmbim i tillë është në përmasa afërsisht të njëjta për të dy Universitetet, kërkesa përkatëse nga njësia akademike mund të bëhet në çdo kohë dhe nuk ka nevojë të aprovohet në Senat. Varësisht nga marrëveshja, shpenzimet lidhur me vizitat e tilla merren përsipër nga Universiteti dërgues ose nga Universiteti pritës.
7. Nëse marrëveshja parasheh që kompensimi i shpenzimeve të shkëmbimit si në paragrafin 6 të mbulohet nga institucioni pritës, UUHP-ja do të mbulojë kompensimin deri në 6 orë ligjërata si në paragrafin 1, përkatësisht 2 të këtij neni, shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit në nivelin siç parashihet në vendimin e Qeverisë për shpenzime jashtë vendit, respektivisht sipas tarifave për vendin e institucionit me të cilin ekziston marrëveshja si në paragrafin 6 të këtij neni.
8. Nëse marrëveshja parasheh që kompensimi i shpenzimeve të shkëmbimit si në paragrafin 6 të mbulohet nga institucioni dërgues, UUHP do t'ia kompensojë stafit të tij deri në 6 orë të mbajtura në shumë prej 180 euro bruto (6\*30 euro). Të gjitha shpenzimet e tjera shoqëruese (udhëtim, akomodim, ushqim) paguhen sipas akteve ligjore në fuqi për udhëtime jashtë vendit. Shpenzimet totale nuk mund të tejkalojnë shumën prej 1,000.00 euro bruto për një profesor vizitor dhe ato paguhen mbi pagën e rregullt që ai/ajo merr në UUHP.
9. UUHP do t'ia mbulojë të gjitha shpenzimet sipas paragrafit 6 për personelin e vet, vetëm nëse UUHP-ja ka një memorandum të mirëkuptimit të nënshkruar me Universitetin pritës në të cilin parashihet shprehimisht shkëmbimi i profesorëve vizitorë.
10. Në rastet kur UUHP-ja ka të nënshkruar memorandum mirëkuptimi me Universitete tjera, e në të cila parashihet shprehimisht shkëmbimi i profesorëve vizitor, një mësimdhënës i UUHP-



së, nuk mund të qëndroj në cilësi të profesorit vizitor më shumë se 1 (një) herë në Universitetin e njëjtë, për lëndë të njëjta. Qëndrimi i përsëritur në Universitetin e njëjtë, por për lëndë të ndryshme, lejohet vetëm nëse nuk ka të interesuar tjerë (përfshirë Prof. asoc. ose Prof. ass.) për realizimin e qëndrimit në Universitetin përkatës.

11. Rektori i UUHP-së nxjerr vendim për secilin profesor vizitor të njërive akademike në të cilin specifikohen përgjegjësitë dhe obligimet përkatëse.
12. Buxheti i ndarë për profesorët miratohet nga Këshilli Drejtues, pas propozimit të Rektorit dhe rishikohet në intervale të caktuara vjetore.
13. Me kërkesë të arsyetuar nga Rektori, skema e përfitueseve nga radhët e profesorëve vizitorë mund të zgjerohet me vendim të Këshillit Drejtues, por brenda lartësisë së buxhetit të aprovuar për vitin përkatës.

#### **Neni 12**

##### **Fondi i orëve për bashkëpunëtorë të jashtëm dhe profesorë vizitorë**

1. Angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime, si dhe i profesorëve vizitorë, bëhet për fond të orëve si në Aneksin 1.

#### **Neni 14**

##### **Kompensimi për pozitat menaxhuese dhe funksioneve tjera në nivel të UUHP-së dhe në njësi akademike**

1. Personeli akademik, në rastet kur ushtrojnë edhe funksionet përkatëse, përfitojnë shtesë funksionale për ushtrimin e funksionit përkatës. Vlera e shtesës nuk mund të kalojë njëzet për qind (20%) të pagës bazë të bartësit të funksionit si në Aneksin nr.2.
2. Në rast se pezullohet angazhimi si staf akademik e profesorit universitar, gjatë ushtrimit të funksioneve si: rektor, prorektor, dekan dhe prodekan, do të zbatohet koeficienti i pagës si në shtojcën përkatëse të Ligjit për pagat në sektorin publik.
3. Profesori universitar i pensionuar, të cilit i është caktuar titulli "Profesor Emeritus" nga Senati, përfiton shtesë mujore prej 20% të pagës bazë të profesorit të rregullt.
4. Në rast se nuk parashihet ndryshe me akt të posaçëm, lartësia e kompensimit për kryetarin dhe anëtarët e Këshillit Drejtues, bëhet në masën tridhjetë për qind (30%) për kryetarin dhe njëzet për qind (20%) për anëtarët, të pagës bazë së zyrtarit kryesor administrativ. Ky kompensim zbatohet për anëtarët e emëruar nga Ministria përgjegjëse dhe për anëtarët e zgjedhur nga Senati.
5. Personeli akademik, nuk mund t'i mbajnë dy funksione si ato me nr. 1 deri 13 të përcaktuara në Tabelën nr. 2.
6. Personelit akademik, në pajtim me këtë rregullore përfiton shtesë funksionale mbi pagën bazë si në Aneksin nr. 2, për ushtrimin e funksioneve të paraqitura në Tabelën nr. 2:

**Tabela nr. 2.**

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi i pozitës</b>
1.	Rektor
2.	Prorektor
3.	Dekan
4.	Prodekan
5.	Shef/koordinator/e i qendrave profesionale në nivel qendror si dhe qendrave që themelohen nga Këshilli Drejtues
6.	Këshilltar i rektorit (i brendshëm)
7.	Koordinator/Këshilltar për zhvillim akademik (ECTS)
8.	Drejtor i institutit (pagesa fillon të implementohet nëse instituti gjeneron të hyra vetanake)
9.	Sekretar i institutit (pagesa fillon të implementohet nëse instituti gjeneron të hyra vetanake)
10.	Shef departamenti
11.	Instruktor në Qendrën për përsosmëri në mësimdhënie për orë mësimi/trajnimi
12.	Anëtar i Senatit (përfshijmë për anëtarët e Senatit nga radhët studenëve dhe kryetarin e Parlamentit Studentor përcaktohet pagesa me vendim të veçantë të Këshillit Drejtues)
13.	Komisioni i studimeve në nivel qendror
14.	Këshilli botues
15.	Komisioni i ankesave dhe parashtrësve të Senatit
16.	Këshilli për cilësi
17.	Këshilli i etikës
18.	Komisioni disiplinor
19.	Komisioni për çështje statutare
20.	Komisioni ankesa dhe parashtrës të Këshillit Drejtues
21.	Komisioni i ankesave në nivel Universiteti
22.	Komisioni i studimeve i njësisë akademike
23.	Komisioni recensues (kryetari) për një pozitë
24.	Komisioni recensues (anëtari) për një pozitë

**Neni 15**  
**Përcaktimi i grupeve në studime (për ligjërata dhe ushtrime)**

1. Formimi i grupeve për ligjërata dhe ushtrime në njësi akademike, do të bëhet në përputhje me kuotën e numrit të studentëve, të lejuar me vendimet respektive të akreditimit/riakreditimit të programeve përkatëse.
2. Grupet e studimit dhe numri i studentëve për grup, përcaktohen me raportet përkatëse të vetëvlerësimit të dorëzuara nga njësitë akademike dhe të miratuara nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë.
3. Vendimin për përcaktimin e grupeve për studime (ligjërata dhe ushtrime) e miraton Senati i UUHP-së me propozim të rektorit të Universitetit.

**Neni 16**  
**Vlefshmëria dhe mbikëqyrja e orëve të mbajtura**

1. Çdo orë e mbajtur arsyetohet me listat elektronike të studentëve, të gjeneruara nga SMU, të verifikuara dhe nënshkruara nga prodekani ose i autorizuari i dekanit të njësisë akademike përkatëse. Me qëllim të kompensimit listat fizike mund të përdoren si dëshmi për mbajtjen e orës vetëm si përjashtim dhe vetëm për shkak të rrethanave objektive<sup>2</sup>, të cilat rrethana duhet të konfirmohen me shkrim nga prodekani për çështje mësimore.
2. Orët e mbajtura online arsyetohen në bazë të evidencës së regjistrimit elektronik të prezencës së studentëve, në bazë të raporteve të gjeneruara nga SMU.
3. Orët e mbajtura nga personeli akademik i pensionuar, bashkëpunëtorët e jashtëm dhe orët shtesë të punës të personelit të rregullt kompensohen në muajin vijues, në bazë të raporteve (elektronike) të dërguara dhe të verifikuara nga prodekani për mësim ose i deleguari nga dekani i njësisë akademike përkatëse.
4. Raportet e verifikuara nga njësia akademike përkatëse dorëzohen për pagesë në shërbimin e pagave deri më datë 5 të muajit vijues. Në rast se raportet e verifikuara të muajt paraprak nuk dorëzohen për pagesë deri me datë 5 të muajit vijues (përjashtimisht ditëve të pushimit), kompensimi nuk mund të realizohet.
5. Raportet për orët e mbajtura më të vjetra se një muaj nuk kompensohen, përjashtimisht me aprovim paraprak nga Senati apo në rastet kur orët e humbura zëvendësohen.
6. Në rast të mos mbajtjes ose mos mbajtjes me rregull të orëve, dekani i njësisë akademike deri me datën 5 të muajt vijues është i obliguar të shqiptojë sanksionet financiare, sipas kësaj rregulloreje, proporcionalisht me shumën e kompensimit të orëve të humbura.
7. Në rastet kur në orë nuk ka marrë pjesë asnjë student, dhe dëshmohet prania e mësimdhënësit në klasë, ora konsiderohet e vlefshme dhe mund të kompensohet.

---

<sup>2</sup> Në këtë rast “rrethanë objektive” konsiderohet ndërprerja e energjisë elektrike dhe problemet eventuale në SMU dhe pajisjet e SMU në salla, të cilat konstatohen nga zyra për teknologji të informacionit në UUHP.

8. Orët mësimore të cilët bien gjatë festave zyrtare të përcaktuara me ligj duhet të zëvendësohen.
9. Në rast se pa arsye personeli akademik nuk dorëzon raportin e orëve të mbajtura deri me datën 5 të muajit vijues, përgjegjësia për mosrealizim të pagesave do të bie mbi të.
11. Përgjashtimisht, në rastet kur në muajin përkatës nuk ka mijete buxhetore për pagesë, pagesa mund të shtyhet për muajt vijues.

#### Neni 17

#### Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Kjo rregullore fillon të zbatohet duke filluar nga viti akademik 2023/24.
2. Me hyrje në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohen të gjitha aktet e brendshme të UUHP-së, të cilat rregullojnë çështje të cilat trajtohen me këtë rregullore.
3. Plotësimi dhe ndryshimi i kësaj Rregulloreje, bëhet në procedurën e njëjtë të miratimit.

#### Neni 18

#### Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli Drejtues.

Prof. Asoc. Dr. Anë Blurrja

*Anë Blurrja*  
Kryesuesi i Këshillit



### ANEKSI NR.1.

Norma e orëve dhe lartësia e kompensimit për orët shtesë të punës së personelit të rregullt akademik, orët mësimore të personelit akademik të pensionuar (të angazhuar në mësimdhënie deri në moshën 70 vjeçare) dhe orët mësimore të personelit të angazhuar në cilësinë e bashkëpunëtorëve të jashtëm.

Tabela nr.3. Llogaritja e kompensimit të personelit të rregullt akademik, për orët shtesë të punës.

Nr.	Thirrja akademike	Orët në javë	Orët në muaj (4 javë)	Paga bazë sipas Ligjit NR. 08_L-196	Totali për muaj - 30% e pagës bazë	Përlllogaritja e orës, duke u bazuar në 30% të pagës bazë
1.	Profesor Asistent	4	16	1092.00 €	327.6 €	20.48 €
2.	Profesor i Asociuar	4	16	1197.00 €	359.10 €	22.44 €
3.	Profesor i Rregullt	4	16	1302.00 €	390.6 €	24.41 €
4.	Asistent	6	24	756.00 €	226.8 €	9.45 €

Tabela nr.4. Llogaritja e kompensimit të personelit akademik të pensionuar (të angazhuar në mësimdhënie deri në moshën 70 vjeçare).

Nr.	Thirrja akademike	Orët në javë	Orët në muaj (4 javë)	Paga bazë sipas Ligjit NR. 08_L-196	Totali për muaj	Përlllogaritja e orës, duke u bazuar në 30% të pagës bazë të profesorit universitar
1.	Profesor Asistent	6	24	1092.00 €	491.52 €	20.48 €
2.	Profesor i Asociuar	6	24	1197.00 €	538.56 €	22.44 €
3.	Profesor i Rregullt	6	24	1302.00 €	585.84 €	24.41 €
4.	Asistent	10	40	756.00 €	378.00 €	9.45 €

**Tabela nr.5. Llogaritja e kompensimit të personelit akademik të angazhuar. me thirrje akademike në njerin nga Universitetet publike në Kosovë**

Nr.	Thirrja akademike	Orët në javë	Orët në muaj (4 javë)	Paga bazë sipas Ligjit NR_08_L-196	Totali për muaj - 20% e pagës bazë	Përlllogaritja e orës, duke u bazuar në 20% të pagës bazë
1.	Profesor Asistent	4	16	1092.00 €	218.40 €	13.65 €
2.	Profesor i Asociuar	4	16	1197.00 €	239.40 €	14.96 €
3.	Profesor i Rregullt	4	16	1302.00 €	260.40 €	16.28 €
4.	Asistent	6	24	756.00 €	151.20 €	6.30 €
5.	Ligjërues	6	24	903.00 €	180.60 €	7.53 €

**Tabela nr.6. Llogaritja e kompensimit të personelit të angazhuar. në njerin nga Universitetet e rajonit dhe më gjerë.**

Nr.	Përshkrimi	Orët në javë	Orët në muaj (4 javë)	Vlera e orës në €	Totali për muaj
1.	Profesor nga vendet e rajonit	6	24	25.00 €	600.00 €
2.	Profesor nga vendet jashtë rajonit	6	24	30.00 €	720.00 €

**Tabela nr.7. Llogaritja e kompensimit të personelit të angazhuar nga jashtë Universitetit, pa thirrje akademike në njerin nga Universitetet publike në Kosovë.**

Nr.	Përshkrimi	Orët në javë	Orët në muaj (4 javë)	Vlera e orës në €	Totali për muaj
1.	Bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata (me gradë Dr.Sc)	6	24	20.00 €	480.00 €
2.	Bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata (pa gradë Dr.Sc) - Ligjërues	10	40	11.00 €	440.00 €
3.	Bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime	10	40	10.00 €	400.00 €



**ANEKSI NR.2.**

**Lartësia e shtesave funksionale dhe kompensimit të funksionit shtesë**

Nr.	Emërtimi i pozitës	Lartësia e kompensimit	Llogaritja e kompensimit në bazë të Opinionit Ligjor me nr. reference 167/2023, datë 07.06.2023 të Departamentit Ligjor të MPB-së
1	Rektor	/	20 % e Pagës bazë të profesorit universitar, sipas Rregullores 09/2023 të Qeverisë, për shtesën funksionale.
2	Prorektor	/	18 % e Pagës bazë të profesorit universitar, sipas Rregullores 09/2023 të Qeverisë, për shtesën funksionale.
3	Dekan	/	15 % e Pagës bazë të profesorit universitar, sipas Rregullores 09/2023 të Qeverisë, për shtesën funksionale.
4	Prodekan	/	13 % e Pagës bazë të profesorit universitar, sipas Rregullores 09/2023 të Qeverisë, për shtesën funksionale.
5	Shef/koordinator/e i qendrave profesionale në nivel qendror si dhe qendrave që themelohen nga Këshilli Drejtues	€ 163.80	Llogaritja e shtesës mujore në lartësi prej 15% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €.
3	Kryesues i Këshillit Drejtues	€ 378.00	Këshilli Drejtues është autoriteti kryesor qeverisës i Universitetit. Llogaritja është bërë në lartësinë prej 30% të pagës bazë të ZKA-së.
4	Anëtar i Këshillit Drejtues	€ 252.00	Këshilli Drejtues është autoriteti kryesor qeverisës i Universitetit. Llogaritja është bërë në lartësinë prej 20% të pagës bazë të ZKA-së.

6	Këshilltar i rektorit (i brendshëm dhe i jashtëm)	/	Personeli mbështetës i rektorit përbëhet këshilltari i jashtëm dhe i brendshëm. Në rastin e këshilltarit të jashtëm, kompensimi bëhet përshatshëmrisht me këshilltarin e Ministrit, ndërsa në rastin e këshilltarit të brendshëm kompensimi bëhet në lartësinë prej 20% të pagës bazë sipas thirrjes akademike që ka i emëruari.
7	Koordinator/Këshilltar për zhvillim akademik (ECTS)	€ 151.20	Llogaritja e shtesës mujore në lartësi prej 20% të pagës bazë të Asistentit, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 7.2x105 €.
8	Drejtor i institutit (pagesa fillon të implementohet nëse instituti gjeneron të hyra vetanake)	€ 75.60	Llogaritja e shtesës mujore në lartësi prej 10% të pagës bazë të Asistentit, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 7.2x105 €. Kompensimi fillon të ekzekutohet me rastin me rastin e gjenerimit të të hyrave nga instituti.
9	Sekretar i institutit (pagesa fillon të implementohet nëse instituti gjeneron të hyra vetanake)	€ 37.80	Llogaritja e shtesës mujore në lartësi prej 5% të pagës bazë të Asistentit, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 7.2x105 €. Kompensimi fillon të ekzekutohet me rastin me rastin e gjenerimit të të hyrave nga instituti.
10	Shef departamenti	/	10 % e Pagës bazë të profesorit universitar, sipas Rregullores 09/2023 të Qeverisë, për shtesën funksionale
11	Instruktor në Qendrën për përsosmëri në mësimdhënie për orë mësim/trajnimi	€ 20.00	Llogaritja e kompensimit për orë mësim/trajnimi, me rastin Qendra gjeneron të hyra dhe si e tillë trajtohet si e hyrë e instituteve pasi është shërbim për ekonominë
12	Anëtar i Senatit (përfshihet për anëtarët e Senatit nga radhët studenëve dhe kryetarin e Parlamentit Studentor percaktohet pagesa me vendim të veçantë të Këshillit Drejtues)	€ 76.44	Llogaritja e shtesës mujore në lartësi prej 7% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €. Nga kjo shtesë përfshihen menaxhmenti qendror dhe dekanët e njësive akademike.

13	Komisioni i studimeve në nivel qendror	€ 54.60	Llogaritja e shtesës mujore në lartësi prej 5% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €.
14	Këshilli botues	€ 54.60	Llogaritja në lartësinë prej 5% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €. Kompensimi bëhet për çdo takim të mbajtur, por jo më shumë se për dy takime në muaj.
15	Komisioni i ankesave dhe parashitresave i Senatit	€ 54.60	Llogaritja në lartësinë prej 5% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €. Kompensimi bëhet për çdo takim të mbajtur, por jo më shumë se për dy takime në muaj.
16	Këshilli për cilësi	€ 54.60	Llogaritja në lartësinë prej 5% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €. Kompensimi bëhet për çdo takim të mbajtur, por jo më shumë se për dy takime në muaj.
17	Këshilli i etikës	€ 98.28	Llogaritja e shtesës mujore në lartësi prej 9% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €.
18	Komisioni disiplinor	€ 98.28	Llogaritja e shtesës mujore në lartësi prej 9% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €.
19	Komisioni për çështje statutare	€ 54.60	Llogaritja në lartësinë prej 5% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €. Kompensimi bëhet për çdo takim të mbajtur, por jo më shumë se për dy takime në muaj.

20	Komisioni ankesa dhe parashtrresa të Këshillit drejtues	€ 54.60	Llogaritja në lartësinë prej 5% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €. Kompensimi bëhet për çdo takim të mbajtur, por jo më shumë se për dy takime në muaj.
21	Komisioni i ankesave në nivel Universiteti	€ 54.60	Llogaritja në lartësinë prej 5% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €. Kompensimi bëhet për çdo takim të mbajtur, por jo më shumë se për dy takime në muaj.
22	Komisioni i studimeve i njësisë akademike	€ 21.84	Llogaritja në lartësinë prej 2% të pagës bazë së Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €. Kompensimi bëhet për jo më shumë se një takim në muaj.
23	Komisioni recensues (kryetari) për një pozitë	€ 54.60	Llogaritja në lartësinë prej 5% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €.
24	Komisioni recensues (anëtar) për një pozitë	€ 32.76	Llogaritja në lartësinë prej 3% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 10.4x105 €.